

PËRGGJIGJE PYETJEVE TË BËRA NGA REPORT TV

1. Sa është numri total i fluturimeve të bëra nga aeroporti Ndërkombëtar Nënë Tereza në vitin 2023?

- Totali fluturime civile (ulje+ngritje) është 50,702 fluturime (TIA, Janar-Dhjetor 2023)

2. Sa është numri fluturimeve të shtyra përgjatë vitit 2023, pra që nuk janë realizuar në datën e parashikuar, sipas kompanive ajrore (na vini në dispozicion listën me emrat e kompanive që kanë pasur shtyrje):

- Përgjatë vitit 2023 janë regjistruar në total 90 anulime.

Tabela 1 sa më poshtë pasqyron në mënyre analitike sipas operatorëve ajrore, anulimet në TIA për periudhën Janar-Dhjetor 2023 si dhe anulimet per 1000 fluturime

Tabela 1: Kompanitë ajrore që kanë kryer anulime gjatë vitit 2023¹

Nr.	Kompanitë ajrore	Anullimet	Numri i fluturimeve (ulje+ngritje)	Anullime/1000 fluturime
1	Air Albania	12	4748	2.4
2	Albawings	2	3172	0.7
3	Wiz Air EU	34	6058	5.7
4	Wiz Air UK	5	1870	2.5
5	Austria Airlines	4	1516	2
6	Lufthansa	11	2082	5.5
7	Air Serbia	6	1216	3
8	ITA/Alitalia	2	864	2
9	Pegasus	4	950	4
10	British Airways	4	744	4
12	Flynas	1	266	1
13	Israir Airlines	1	70	1
14	Others	4	1810	2

¹ Market share është përlogaritur nga totali i fluturimeve (ulje- ngritje) për vitin 2023

Sikurse shihet nga tabela mesiperme kompanite qe kane bere anulime me se shumti jane kompanite qe operojne ne Europe.

3. Sa është numri i fluturimeve përgjatë vitit 2023, që janë shtyrë për disa orë, pra fluturimi ka nisur me vonesë, sipas kompanive (na vini në dispozicion listën me emrat e kompanive që kanë pasur vonesa)?

- Përgjatë vitit 2023 ka pasur në total 281 vonesa mbi 3 orë.

Tabela 2 sa më poshtë pasqyron në mënyrë analitike vonesat në TIA për periudhën Janar-Dhjetor 2023 sipas operatorëve ajrore si dhe vonesat per 1000 fluturime.

Tabela 2: Kompanitë ajrore që kanë kryer vonesa mbi 3 orë gjatë vitit 2023²

Nr.	Kompanitë ajrore	Vonesat mbi 3orë	Numri fluturimeve(ulje+ngritje)	Market share
1	Air Albania	4	4748	1
2	Albawings	20	3172	6.7
3	Wiz Air EU	161	6058	26.8
4	Wiz Air UK	51	1870	25.5
6	Austria Airlines	1	1516	0.5
7	Lufthansa	4	2082	2
8	Air Serbia	1	1216	0.5
12	Pegasus	3	950	3
13	British Airways	3	744	3
14	Swiss	2	544	2
16	Easy Jet UK	3	288	3
17	Lot Airline	2	692	2
18	Transavia -FR	2	116	2
19	Euroëings	3	300	3
20	Ryan Air	13	1320	6.5
21	Enter	3	374	3
22	Israir Airlines	1	70	1
23	Others	4	1810	2

² Market share është përlogaritur nga totali i fluturimeve (ulje- ngitje) për vitin 2023

3/1 Cilat kanë qënë arsyt kryesore të shtyrjeve apo vonesave të fluturimeve vjet?

Arsyt kryesore të vonesave mbi 3 orë përgjatë 2023 kanë qënë:

- *Vonesë nga fluturimet paraardhëse të inicuar në aeroporte të Komunitetit Evropian apo jashtë saj*
- *Mot i keq*
- *Probleme/difekte teknike*
- *Mungesë ekuipazhi (vijim i rikuperimit pas Covid-19) apo stafi perpunues dhe sigurie në Aeroporte*
- *Greva të sindikatave të ndryshme në fushën e aviacionit civil*
- *Aktivitetet ushtarake në hapsirën Evropiane*

4. Sa është vlera e dëmshpërblimeve të dhëna vjet nga kompanitë për vonesa në fluturime apo anulim të fluturimeve? (Lista e kompanive dhe e dëmshpërblimeve)

Autoriteti i Aviacionit Civil në funksionet dhe kompetencat e tij sipas bazës ligjore që rregullojnë zbatimin e të drejtave të pasagjerëve, nuk mbledh informacion për vlerën e dëmshpërblimit që ka kryer çdo kompani ajrore, por vetëm mbështet pasagjerët në procesin e kompensimit ligjor që u takon, kur kërkohet nga to.

5. Sa ankesa kanë bërë qytetarët për kompanitë që nuk kanë respektuar oraret?

Përgjatë vitit 2023 janë adresuar pranë Autoritetit të Aviacionit Civil 214 ankesa, nga të cilat 28 i përkasin muajve të fundit të vitit 2023 duke qënë kështu ende brenda afateve që kompanitë ajrore duhet t'i shqyrtojnë. Aktualisht janë trajtuar dhe kompensuar 121 pasagjerë dhe pjesa tjetër, 65 janë në proces.

6. A parashikohet të ketë vonesa edhe këtë vit (2024) në fluturime? Nëse po, për cilat arsye?

Nëse i referohemi të dhënave të Eurocontrol, si dhe arsyeve vonesave të cituara në pikën 3.1, parashikohet të ketë vonesa edhe gjatë vitit 2024 për shkak të grevave të paparashikura, motit të keq, kapaciteteve aeroportuale të limituara, mungesës së stafeve në avion dhe aeroporte, mos lejimin e fluturimit të 114 avioneve për shkak të problemeve të shfaqura.

7. Sa fluturime janë bërë nga aeroporti i Kukësit gjatë viteve 2021,2022,2023 dhe drejt cilave destinacione?

Në Aeroportin Ndërkombëtar të Kukësit janë kryer fluturime sipas viteve, si më poshtë:

Tabela 3: Fluturime total KFZ, 2021, 2022, 2023

Total viti 2021	Total Viti 2022	Total viti 2023
128 fluturime	442 fluturime	210 fluturime

Destinacionet kryesore të fluturimeve në vitin 2023 në KFZ, kanë qënë Basel, Memmingen, Baden Baden, Vjena

8. A mund të na jepni më shumë informacion mbi certifikimin e avionëve të NATO-s, që do të bëhet në Shqipëri? Kur nis procesi, si do të zhvillohet, çfarë përfitojmë, a ka kosto financiare etj

Per shkak te rritjes se operimeve ushtarake (te cilat ndahen ne fluturime luftarake dhe fluturime per transport) dhe standartit qe keta avione te plotesojne kerkesat e vlefshemrise ajrore, NATO kerkon nga vendet anetare mbeshtetje ne keto aktivitetete. Kriteri I perzgjedhjesgjes eshte raporti I auditeve te Organizates Boterore te Aviacionit Civil ne lidhje me kapacitetet qe shtetet zoterojne. Procesi do te filloje ne tremujorin e fundit te vitit 2024 ku Autoriteti I Aviacionit Civil do te auditohet nga NATO per te verifikuar kwerkesat. Procesi pritet te perfundoje ne tremujorin e dyte te vitit 2026, kun je certificate pranimi do te leshohet nga nATO. Procesi nuk ka kosto, pasi ajo qe kerkohet eshte kompetenca e burimeve njerezore te Autoritetit te Aviacionit Civil